

VENDIM
Nr.967, datë 2.7.2008

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE KRYESORE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË
UNIVERSITETIN USHTARAK “SKËNDERBEJ”, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 e 35 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat kryesore të pranimit, në universitetin ushtarak “Skënderbej”, për vitin akademik 2008-2009, të jenë 140 (njëqind e dyzet) studentë, nga të cilët 15-20 për qind të jenë femra, të ndara si më poshtë vijon:

- Fakulteti i Menaxhimit, dega administrim-biznes, 90 (nëntëdhjetë) studentë.
- Fakulteti Teknik, dega elektronikë, 50 (pesëdhjetë) studentë.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha